



## Aplikim për vizë me qëllim kualifikimi ose praktike

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit dhe përmbajuni saktësisht udhëzimeve.

Aplikimet e plotësuar në mënyrë të mangët apo dokumentacioni i paplotë mund të çojnë në refuzimin e aplikimit. Si pasojë do të nevojitet rezervimi i një date të re aplikimi përfshirë periudhat përkatëse të pritjes.

Në rastin e aplikimit për vizë Ambasada, duhet të përfshijë në procedurë zyrën përkatëse në Gjermani. Në varësi të qëndrimeve paraprake përgjigja mund të zgjasë deri në tre muaj. Ndaj lutemi që të aplikoni për vizë në kohën e duhur, sikundër edhe për mirëkuptimin Tuaj që brenda 12 javëve të para, prej ditës së aplikimit, nuk mund t'u japim përgjigje pyetjeve lidhur me stadin aktual të procedurës.

### Për aplikimin ju nevojitet dokumentacioni në formën e përshkruar më poshtë:

1.	<b>Formularë aplikimi për vizë</b>	Në gjermanisht ose anglisht, <b>2 copë</b> , të plotësuar në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkruara personalisht.
2.	<b>Tarifa</b>	Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhen <b>kesh në monedhën shqiptare LEK</b> . Tarifa është 75,00 Euro përllogaritur me kursin aktual të këmbimit.
3.	<b>Fotografi pashaporte</b>	3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë, madhësia 45x35 mm. Lutemi që në secilin prej dy formularëve të aplikimit të ngjisni nga një fotografi, ndërsa fotografinë e tretë silleni me vete si element të veçantë.

### Dokumentat e mëposhtme duhen dorëzuar në origjinal, me 2 fotokopje, në momentin e aplikimit

4.	<b>Pashaporta e udhëtimit</b>	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.
5.	<b>Kontratë e nënshkruar kualifikimi ose praktike</b>	Kontrata e kualifikimit ose e praktikës në origjinal, duhet të përmbajë të dhëna të sakta sa më poshtë: Lloji, përmbajtja dhe kohëzgjatja e veprimtarisë së synuar, koha e punës, vendi i punës, vlera e pagës. Nëse prej kontratës nuk rezulton përmbajtja e kualifikimit / praktikës së synuar, duhet të paraqitet një plan më vete i kualifikimit/praktikës.

6.	<b>Dëshmi kualifikimi</b>	P.sh. diploma, dëshmi, libreza e punës e përkthyer dhe dëshmi për gjuhën e kualifikimit. Udhëzim: Çertifikatat shqiptare duhet të jenë të pajisura me vulë apostile dhe të përkthyer në gjermanisht
7.	<b>Curriculum Vitae (nëse kërkohet)</b>	Curriculum Vitae i formuluar nga vetë aplikuesi, duke paraqitur në mënyrë të veçantë kualifikimin dhe eventualisht veprimtarinë profesionale të deritanishme.
8.	<b>Dëshmi e gjuhës gjermane</b>	Dëshmi për përvetësimin e suksesshëm të njohurive të gjuhës gjermane minimalisht në nivelin A2 (në rastin e një profesioni të rregulluar me ligj në fushën e mjekësisë minimalisht B2) ose vërtetim nga qendra e punës, që njohuritë e gjuhës në nivelin A2 resp. B2 nuk janë të nevojshme (dhe pse)
9.	<b>Eventualisht dëshmi për një siguracion shëndetësor të mjaftueshëm</b>	Kjo dëshmi duhet të paraqitet, vetëm nëse prej kontratës së punës nuk rezulton se është punëdhënësi, ai që e merr përsipër siguracionin shëndetësor.
10.	<b>Eventualisht dëshmi për financa të mjaftueshme për jetesën</b>	Nëse paga gjatë kualifikimit / praktikës nuk arrin vlerën e 800,-- eurove në muaj, atëherë është e nevojshme paraqitja e një dëshmie për pjesën e munguar të financimit, si p.sh. në formën e një deklaratë garancie <u>ose</u> dëshmia e hapjes së një llogarie bankare të bllokuar. Lidhur me këto të fundit dhe mundësi të tjera financimi lutemi të njiheni me informacionet në faqen e internetit të Ambasadës: <a href="http://www.tirana.diplo.de">www.tirana.diplo.de</a> .

Në raste të veçanta, gjatë aplikimit apo procedurës së vizës, mund të kërkohen nga Ambasada dokumenta të caktuara të papërmendura më sipër.

**Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:**

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.